REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E MITROVICES/OPSTINA MITROVICA
QENDRA PER PUNE SOCIALE / CENTAR ZA SOCIJALNI RAD
Nr. Fq. / Br. Str. 19 Nr. Prot. / Br. Prot. 0083169/24
Data / Datum 31 / 12 / 2024

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

**Komuna e Mitrovicës së Jugut**

Opština Južna Mitrovica - MunicipalityofMitrovica South

**Qendra për Punë Sociale - Mitrovica e Jugut**

# PLANI I PUNËS

# I QPS- SË MITROVICA E JUGUT PËR VITIN 2025

**Mitrovicë, Dhjetor 2025**

**PËRMBAJTJA**


Hyrje.......4

- Misioni dhe
- Qëllimi i QPS-së

1. **Mbrojtja e drejtpërdrejtë e shfrytëzuesve**.......5

2. **Fëmijët e keqtrajtuar, të rrezikuar nga dhuna familjare, të lënë pas dore dhe puna e rrezikshme**.......6

3. **Mbrojtja e fëmijëve dhe të rinjve që kanë rënë konflikt me ligjin**.......8

4. **Mbrojta e fëmijëve, prindërit e të cilëve janë shkurorëzuar**.......9

6. **Mbrojtja e fëmijëve me nevoja të veçanta**.......10

7. **Mbështetja e fëmijëve**.......11

**11.1** viktimë e trafikimit

**11.2** prostitucionit dhe

**11.3** formave tjera të rënda të punës

8. **Të rinjtë që kërkojnë mendim për hyrje në martesë para moshës madhore**.......12

9. **Shërbimet tjera**.......13

**13.1 B.** Të rriturit

**13.2 C.** Të moshuarit

10. **SHËRBIMI I SAS-it**.......17

11. **Shërbimi – Administrata dhe Zyra për Buxhet dhe Financa**.......18

12. **Aktivitetet e ndryshme të planifikimit si të domosdoshme për QPS**.......19

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **MBROJTJA E DREJTË PËR DREJTË E SHFRYTËZUESVE**<br><br>**1.Fëmijët dhe të miturit**<br><br>Trajtimi adekuat dhe mbrojtja e fëmijëve pa kujdes prindëror, me qëllim të sigurimit të mbështetjes individuale, familjare për një të ardhme me kuptim të mirëfilltë.<br><br>Qëllimi primar i punës me këtë kategori duhet të jetë përmirësimi kualitativ i jetës së tyre, edukimi dhe ofrimi i përkrahjes së vazhdueshme.<br><br>**Objektivat tona do të fokusohen në trajtimin e të gjithë fëmijëve :**<br><br>➢ pa të dy prindërit,<br>➢ fëmijëve të braktisur<br>➢ prindërve. të cilëve iu është marrë e drejta prindërore. | Ligji për familjen, Ligji për Shërbime Sociale **KPPK. KPPPK.**<br><br>Ligji për të mitur, dhe aktet tjera ligjore. | Identifikimi i rasteve dhe implementimi i kërkesave dhe nevojave të fëmijëve pa kujdes prindërorë do të realizohet me përkrahjen dhe ofrimin e shërbimeve, varësisht nga rastet me këto forma të mbrojtjes:<br><br>a. vënia nën kujdestari,<br><br>b. vendosja në strehim familjar në strehim institucional, OJQ përkatëse, përkujdesje dhe përcjellje permanente mbi gjendjen e tyre,<br><br>c. adoptimi, përzgjedhja e familjeve të përshtatshme,<br><br>d. raportimi mbi paraqitjen dhe gjendjen e këtyre rasteve. | **I përhershëm** | **MFPT / MD** | **MFPT / MD,DMS,OJQ,**<br><br>**Shkollat, Gjykatat PK,MV, etj.** | 1.Qendra për Punë Sociale si Institucion profesional i nivelit komunal, planifikon që të organizoj fushatë sensibilizuese me akteret ndërveprues, për ti parë mundësit e rekrutimit të familjeve strehuese për të cilën paraprakisht kemi zotimin e OFAP-it dhe SOS-Fshati për mbështetje.<br><br>Arsye pse objektivi i vitit 2024 nuk është arritur plotësisht, për rekrutimin e familjeve strehuese sipas planifikimit ka qenë mungesa e informimit qytetar për tu bërë pjesë kësaj veprimtarie, andaj ne si QPS, kemi krijuar mekanizma të besueshëm dhe me ndikim që për vitin 2025, popullata e gjerë të informohet mirëfilli dhe të kuptoj rëndësinë e familjeve strehuese.<br><br>Për ta arritur këtë objektiv, në si QPS së bashku me të gjithë akterët ndërveprues komunal, OJQ-ve të specifikuara më lartë dhe partnerëve të tjerë mbështetës do t'i ndërmarrim hapat konkret dhe të nevojshëm që të arrijmë qëllimet tona në përmbushjen dhe mbrojtjen e interesave qytetare. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Sa i përket aspektit të rrezikshmërisë që ka të bëjë me të miturit, organi i kujdestarisë në përputhje me legjislacionin në fuqi kur konsideron se një i mitur është i rrezikuar ka mandatin e plotë për të ndërhyrë me qëllim evitimin e rrezikut i cili potencialisht mund të i kanoset një të mituri. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **4. Mbrojta e fëmijëve, prindërit e të cilëve janë të shkurorëzuar apo në shkurorëzim e sipër .**<br><br>Organi i Kujdestarisë në përputhje me mandatin e vet për kategorinë në fjalë sipas planifikimit të vet, ndërmerr veprime si përpjekje për rregullimin e marrëdhënieve bashkëshortore mbi vullnetin e lirë të palëve.<br><br>Nëse një gjë e tillë nuk është e mundur të arrihet, atëherë pikë orientuese për ne është interesi më i mirë i fëmijëve dhe për një gjë të tillë, duhet të shikohen mundësit që cili prind mund ti mbroj më mirë interesat e fëmijëve e po ashtu sipas nevojës në kategoritë e tilla tentohet të lehtësohet aspekti i kontaktimit të prindit që fëmijët nuk i ka në kujdes. | *Legjislacioni në fuqi* | Për realizimin e objektivave të punës me fëmijët e kësaj kategorie do të zbatohen, procedurat e nevojshme që parasheh ligji:<br><br>a. Procedura e pajtimit me bashkëshortët mbi vullnetin e lirë me qëllim të rregullimit të raporteve të tyre,<br><br>b. Mendimi për besimin e fëmijëve në ruajtje dhe edukim si dhe mënyrën e kontaktimit me prindin tjetër, dhe<br><br>c. raportimi për punën me këto raste. | **I përhershëm** | **MFPT / MD,OJQ-të PK,MV etj.** | **MFPT / MD, DMS, OJQ, Shkollat, Gjykatat PK,MV, etj.** | Në raport me rrezikshmërinë që ka të bëjë me të miturit Organi i Kujdestarisë në përputhje me legjislacionin në fuqi në rrethana, kur konsideron se një i mitur është i rrezikuar, ka mandatin e plotë për të ndërhyrë dhe atë me qëllim evitimin e rrezikut i cili potencialisht mund të i kanoset një të mituri , e në lidhje me këtë QPS ka kapacitete të plota që kategorisë në fjalë ti dal në ndihmë në rrethana, kur mëson se një i mitur ndodhet në një situatë të tillë. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **7. Të rinjtë që kërkojnë mendim për hyrje në martesë para moshës madhore .**<br><br>Një kategori e tillë ka bazën e vet ligjore e cila kryhet në bashkëveprim me Gjykatën. Kjo kërkesë iniciohet përmes gjykatës.<br><br>Organi i kujdestarisë ka kapacitete të plota që për vitin 2025 këtë fushë ta mbulojë në mënyrë të duhur efikase dhe pa vonesa, pasi që ka kapacitete humane të mjaftueshëm dhe po ashtu edhe infrastrukturën e nevojshme . | ***Legjislacioni në fuqi*** | Identifikimi i këtyre rasteve do të realizohet në bashkëpunim me PK, gjykatën dhe OJQ-të. Ofrimi i shërbimeve këshillëdhënëse dhe përkrahja e tyre me qëllim, ri-integrimin në familje dhe raportimi me kohë institucioneve përkatëse lidhur me statusin dhe gjendjen e tyre.<br><br>Aplikimi i procedurave të nevojshme me qëllim të vlerësimit të kritereve që duhet plotësuar të rinjtë që kërkojnë lidhje të martesës para moshës madhore si dhe ~~dhënia e mendimit lidhur me~~ këto kërkesa.<br><br>Raportimi: DMS-DMS,ZSHS- do të shqyrtojnë të gjitha kërkesat e qytetarëve që vlerësohen se janë në kompetencë të Qendrës e që janë të cekura në objektiv të shërbimeve<br><br>Raportimi: DMS. | **I përsheshem** | **MFPT / MD, POK, OJQ** | **MFPT / MD,OJQ,** | Ne si QPS do të trajtojmë këtë kategori në bazë të mandatit tonë si dhe në bazë të kompetencave në bashkërendim me institucionet tjera dhe atë sipas rrjedhës ligjore për këto raste . |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **B. TË RRITURIT**<br><br>Shqyrtimi i kërkesave të të rriturve për zgjidhjen e martesave dhe përmirësimin e marrëdhënieve të çrregulluara familjare do të trajtohet me kujdes të veçantë nga shërbimi social. Ky shërbim do të punojë ngushtë me bashkëshortët që kërkojnë zgjidhje për martesën ose duan të përmirësojnë marrëdhëniet familjare të tensionuara. | **Legjislacioni në fuqi** | Përkujdesja e vazhdueshme për zbatimin dhe realizimin e nevojave, si dhe monitorimin e shpenzimeve të lidhura me përdorimin e mjeteve financiare. | **I përhershëm** | **MFPT / MD-DMS** | | B. Nga Stafi i QPS-së të mandatuar për sanimin e marrëdhënieve bashkëshortore, kërkohet një përkushtim profesional për tentim pajtimi , duke vlerësuar rrethanat gjithëpërfshirëse për të dhënë një mendim adekuatë. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | d. Ndihmën për të lëvizur dhe për tu ngritur, të cilët për shkak të moshës dhe aftësive të kufizuara ose sëmundjes nuk mund të kryejnë vet pasi që kategoria në fjalë nga kanë familje apo ndonjë ndihmë tjetër .<br><br>e. Hapja e një qendre ditore për individët e cenueshëm për tu ushqyer ,mbajtur higjienën personale apo çfarëdo aspekti tjetër të këshillimit dhe përkujdesjes sociale .<br><br>ë. Kapacitete të kufizuara institucionale për përkujdesje të kësaj kategorie .<br><br>f. Të fuqizohet iniciativa për hapjen e shtëpisë për peronat e moshuar dhe pa përkujdesje në këtë aspekt ne si QPS do të evokojmë tek institucionet tjera relevante dhe atë me qëllim që edhe ne si komunë ta kemi shtëpinë për përkujdesje të personave të moshuar dhe ne nevojë.<br><br>g. Adresimi për blerje të shërbimeve për këtë kategori nga OJQ . |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **III. SHËRBIMI – ADMINISTRATA DHE ZYRA PER BUXHET DHE FINANCA**<br><br>Implementimi i ligjeve dhe rregulloreve në fuqi që kanë të bëjnë me Administratën dhe Zyrën për Buxhet dhe Financa | **Legjislacioni në fuqi** | Ngritja e buxhetit për QPS-në për vitin 2025. Bashkëpunimi në mes QPS-së ,DIEMS,DBF dhe Prokurimit. Përkujdesja permanente për implementimin dhe realizimin e nevojave dhe përcjelljen e shpenzimeve të dhëna lidhur me mjetet financiare. | Tre mujor-Gjashtë mujor Nëntë mujor dhe Vjetor<br><br>**32,660.00 euro.** | **MFPT / MD** | Divizioni i Asistencës sociale- **MFPT / MD-DMS** | Sa i përket aspektit të Financave Zyra për Buxhet dhe Financa ka planifikuar që kjo pjesë të jetë e orientuar në funksion të gjërave të nevojshme me të cilat funksionon ky institucion me qëllim përmbushjen e nevojave të përgjithshme të 20 zyrtarëve (punësuarve) në QPS . Shpenzimet financiare për vitin vijues fiskal 2025 i kemi planifikuar në dy kodet 130 Mallra dhe Shërbime dhe 132 Shpenzimet Komunale. Planifikojmë për vendosjen e 6 Klimave AC inverter,8 Kompjuter PC me të gjitha pajisjet , 9 Printer-Skaner me pajisjet përcjellëse ,19 Karrige Lëvizëse për zyrtarët , 8 Karrige Statike për pale , 11 Panele 60x60 led për Ndriçimin e 11 zyrave , 8 Zyre të kompletohen me mobile me nga ,1 tavolinë pune , 1 tavolinë pritëse-, 2 dollapa për regjistrator ,2 dollapa me fiok, 2 Pajisje kundër zjarrit , 18 Ora muri për të gjitha zyrat , 2 Kutia të ndihmës së parë , Afër 800 metra katror për lyerjen e të gjitha zyrave dhe hapësirave të QPS-së, Fonde sensibilizuese ,Broshura vetdijesuese , Pajisjen e dy banjave me nga një pasqyre dhe me nga një aparat të pallmave për tharjen e duarve , Planifikojmë dy dreka për dy zyrtarët që do pensionohen, si dhe tek Shpenzimet Komunale planifikojmë që ti kryejmë të gjitha pagesat që na atribuohen neve si Qendër për Punë Sociale . |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Aktivitete të ndryshme të planifikuara për tu realizuar nga QPS-Mitrovica e Jugut në vitin 2025** | **Legjislacioni në fuqi** | 1. Nxjerrja e Rregullores së brendshme të punës.4. Funksionalizimi i ueb-faqes.<br><br>5. Themelimi i komisionit për shqyrtimin e ankesave të vendosura në Kuti të ankesave pas funksionalizimit të saj.<br><br>6. Organizimi i vizitave në institucionet Arsimore me qëllim parandalimin e dukurive negative .<br><br>7. Një ndër zotimet që planifikojmë për vitin 2021 është edhe adresimi për rekrutimin e dy punonjësve zyrtar të Asistencës Sociale pasi që ky sektor është i ngarkuar tej mase për punët që kryen dhe është në Disproporcion me standardin ligjor zyrtar numër banori andaj duke pasur për bazë këtë disproporcion arsyeshëm planifikojmë që të instancat kompetente të kërkojmë të plotësohen pozitat në fjalë.<br><br>8.Krijimin e një fondi të veçantë për nevojat e qytezave të cilët janë në nevojë ekstreme që ne punën tonë konsistojnë gjatë intervistimit në Polici. | **Për vitin 2025** | **QPS-DMS-KK. Mitrovica e Jugut** | **MS,PK,OJQ etj.** | Planifikimet e bazuara, mbi zotimin e plan projektit për vitin 2025 vijojnë si më poshtë<br><br>1. Trajnime, ku përfshihet stafi në trajnime mbi menaxhimin e konflikteve, lidershipin, zhvillimin e kapaciteteve profesionale .<br><br>Në kuadër të trajnimeve theks i veçantë bie mbi trajtimin e traumave implementimi i pyetësorëve mbi identifikimin e dhunës ,traumës , keqtrajtimit për fëmijë dhe të rriturve .<br><br>**2.**Planifikimi i buxhetit mbi hartimin e broshurave informuese .<br><br>Përgatitja dhe shpërndarja e broshurave të qarta dhe tërheqëse të cilat adresojnë tematika kyçe dhe të cilat ofrojnë informacione të dobishme për komunitetin mbi temat e caktuara dhe njëherazi të ndjeshme .<br><br>3. Pyetësorë mbi evidentimin e punës profesionale .<br><br>Financimi i pyetësorëve dhe trajnimeve mbi teknikat e aplikimit të inventarëve/pyetësorëve të karakterit identifikues .<br><br>4.Sesione sensibilizuese në vazhdimësi mi temat dhe grupet e synuara/margjinalizuara<br><br>Realizimi i eventeve edukative për fëmijët e shkollave fillore dhe të mesme brenda komunës së Mitrovicës, me qëllim ndërgjegjësimin mbi çështjet kyçe si; |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Dhuna ,shëndeti mendor ,përfshirja sociale, vetëdijesimi mbi pasojat e sjelljeve asociale/ në konflikt me ligjin, pasojat e trafikimit, martesat e hershme ,dhuna në familje me theks të veçantë ndaj të miturve ,vetëdijesimi mbi shkaqet dhe pasojat e fëmijëve lëmosh kërkues.<br><br>**Në aspektin infrastrukturor dhe të burimeve njerëzore, nevojat e Qendrës për Punë Sociale janë si në vijim :**<br><br>**1.** Lyerja dhe modifikimi i objektit ku Qendra për Punë Sociale në Mitrovicë ushtron aktivitetin e saj profesional .<br><br>2. Nga aspekti i burimeve njerëzore siç është planifikuar parashihen që të zhvillohen procedurat e rekrutimit për pozitat si në vijim :<br><br>➢ Tre zyrtar të Asistencës Sociale në Sektorin e Skemës së Ndihmave Sociale<br>➢ Një pozitë Zyrtar për Shërbime Sociale në Sektorin e Shërbimeve Sociale |

**Vendi : Mitrovica e Jugut , Datë:31.12.2024**

**I dërgohet**

**DMS-së dhe Arkivit**

**Drejtori i QPS-së , z.Gani Mustafa**

REPUBLIKA E KOSOVËS – KOMUNA E MITROVICËS – REPUBLIKA KOSOVA